

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

**“RIPARIME
ELEKTROSHTËPIAKE”**

Kodi: PK-E-1-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2018

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“RIPARIME ELEKTROSHTËPIAKE”

(PK-E-1-18)

I. Profili Profesional i riparuesit elektroshtëpiak

a) *Karakteristikat e riparuesit elektroshtëpiak*

Riparuesi elektroshtëpiak është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në pika servisi riparimesh të pajisjeve elektroshtëpiake.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, riparuesi elektroshtëpiak duhet që të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të riparuesit elektroshtëpiak.

Suksesi i riparuesit elektroshtëpiak është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e riparuesit elektroshtëpiak:*

Profesioni i riparuesit elektroshtëpiak është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kontrollin, diagnostikimin, riparimin apo zëvendësimin e pjesëve në pajisjet e dëmtuara si dhe shërbime të ndryshme të elementëve mekanike, elektrike dhe elektronike të pajisjeve elektroshtëpiake. Ai mund të punësohet ose të vetëpunësohet në reparte shërbimesh dhe riparimesh të këtyre pajisjeve, si dhe në kompani shitjeje. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e riparuesit elektroshtëpiak të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një riparues elektroshtëpiak mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit.

Për të zhvilluar aktivitet privat në fushën e riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Riparues të pajisjeve elektroshtëpiake dhe të tjera”, me kod 7414, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: riparues i pajisjeve frigoriferike, riparues i pajisjeve larëse etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Riparime elektroshtëpiake

Në përfundin të kursit për Riparime elektroshtëpiake, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për riparime elektroshtëpiake.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës në repartin e riparimeve elektroshtëpiake.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet, makineritë dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Përdorin dhe interpretojnë skica dhe skema të thjeshta elektrike dhe mekanike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- Përdorin drejt veglat e pajisjet e punës gjatë riparimeve elektroshtëpiake.

- Riparojnë elementet kryesore të pajisjeve të thjeshta elektroshtëpiake.
- Riparojnë pajisjet elektrike ventiluese, ngrohëse e aspiruese.
- Riparojnë sobën e gatimit.
- Riparojnë frigoriferin shtëpiak.
- Riparojnë makinën larëse, makinën tharëse të rrobave dhe makinën larëse të enëve.
- Riparojnë pajisjet e vogla elektroshtëpiake.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta të riparimeve elektroshtëpiake.
- Zbatojnë standardet e profesionit gjatë kryerjes së riparimeve elektroshtëpiake.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- Komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Riparime elektroshtëpiake.

Pjesmarrësit në Kursin për riparime elektroshtëpiake duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Riparime elektroshtëpiake

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Riparime elektroshtëpiake

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e riparuesit elektroshtëpiak	MK-11-051-18	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vleresime;	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit elektroshtëpiak. 2. Kursanti përshkruan nocionet dhe ligjet bazë të elektricitetit. 3. Kursanti interpreton skemat elektrike dhe kinematike të pajisjeve elektroshtëpiake. 4. Kursanti përshkruan nocionet bazë të mekanikës. 5. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.
2	Riparimi dhe zëvendësimi i elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake	MK-11-052-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	1. Kursanti riparon motorë elektrikë. 2. Kursanti zëvendëson elemente të pajisjeve elektroshtëpiake. 3. Kursanti riparon pompa të ujit
3	Riparimi i pajisjeve elektrike ventiluese, ngrohëse e aspiruese	MK-11-053-18	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti riparon ventilatorin. 2. Kursanti riparon aerotermin. 3. Kursanti riparon thithësin e avujve.

4	Riparimi sobës së gatimit.	MK-11-054-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen punime riparimi në pianurën e sobës elektrike të gatimit. 2. Kursanti riparon furrën elektrike të sobës elektrike. 3. Kursanti riparon sobën me gaz të gatimit.
5	Riparimi i frigoriferit shtëpiak	MK-11-055-18	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen riparimin e defekteve të thjeshta të frigoriferit. 2. Kursanti kryen riparime në sistemin elektrik të frigoriferit. 3. Kursanti riparon sistemin e qarkullimit të gazit të frigoriferit.
6	Riparimi i makinave larëse dhe tharëse	MK-11-056-18	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti riparon makina larëse të rrobave 2. Kursanti riparon makina tharëse të rrobave. 3. Kursanti riparon makina larëse të enëve
7	Riparimi i pajisjeve të vogla elektroshtëpiake.	MK-11-057-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përgatit riparimin e pajisjeve. 2. Kursanti riparon pajisjet.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Riparime elektroshtëpiake

1. Moduli “Hyrje në profesionin e riparuesit elektroshtëpiake”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E RIPARUESIT ELEKTROSHTËPIAK.	MK-11-051-18
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë, funksionet, detyrat, veprimtaritë profesionale, parimet dhe kërkesat kryesore të riparuesit elektroshtëpiake, me nocionet dhe ligjet bazë të elektricitetit, skemat elektrike dhe kinematike, me konceptet bazë të mekanikës që zbatohen në pajisjet elektroshtëpiake, me mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparuesit elektroshtëpiake, si dhe me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të riparuesit elektroshtëpiake. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.– të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore– të punës së riparuesit elektroshtëpiake.– të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së riparuesit elektroshtëpiake.– të përshkruajë veglat kryesore që përdoren në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake dhe fushën e përdorimit të tyre.– të përshkruajë llojet, përdorimin dhe vetitë e materialeve që përdoren në riparimet e pajisjeve elektroshtëpiake.– të përshkruajë llojet dhe përdorimin e pajisjeve elektroshtëpiake.– të theksojë rreziqet nga rryma elektrike.– të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga rryma elektrike.– të përshkruajë rëndësinë e kompletit të veshjes dhe mjeteve mbrojtëse të riparuesit të pajisjeve elektroshtëpiake.– të përshkruajë mënyrën se si jepet ndihma e parë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.– të përshkruajë rregullat e mbrojtjes së mjedisit gjatë	

-
- ushtrimit të veprimtarive profesionale të riparuesit elektroshtëpiak.
- të tregojë organizimin në një repart riparimi elektroshtëpiak.
 - të përshkruajë kërkesat profesionale për riparuesit elektroshtëpiak.
 - të tregojë mundësitë e punësimit të riparuesit elektroshtëpiak.
 - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të riparuesit elektroshtëpiak.
 - përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan nocionet dhe ligjet bazë të elektricitetit

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë konceptin e rrymës elektrike dhe llojet e saj.
- të tregojë madhësitë elektrike (I, U, R, P). dhe raportet kryesore ndërmjet tyre.
- të përkufizojë ligjin e Ohmit.
- të tregojë zbatimet e ligjit të Ohmit në praktikë.
- të përshkruajë efektet kryesore të rrymës elektrike dhe zbatimet e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan dhe interpreton skemat elektrike dhe kinematike të pajisjeve elektroshtëpiake.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë skemat elektrike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të interpretojë skemat elektrike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të interpretojë simbolet kryesorë që përdoren në skicat dhe skemat elektrike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të përshkruajë skemat kinematike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të interpretojë simbolet kryesorë që përdoren në skicat dhe skemat kinematike të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të interpretojë skemat kinematike të pajisjeve elektroshtëpiake.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 4 Kursanti përshkruan nocionet bazë të mekanikës.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë konceptet e ngarkesave mekanike në tërheqje, shtypje, përkulje, përdredhje
- të shpjegojë kuptimin e qëndrueshmërisë ndaj ngarkesave mekanike
- të përshkruajë materialet kryesore metalike, vetitë dhe përdorimet e tyre
- të përshkruajë detalet dhe nyjet mekanike dhe përdorimet e tyre
- të përshkruajë mekanizmat kryesore mekanike dhe përdorimet e tyre
- të tregojë shkaqet dhe pasojat e konsumimit të detaleve
- të tregojë rëndësinë dhe përdorimin e lubrifikuesve
- të tregojë metodat kryesore të riparimit të detaleve dhe përdorimet e tyre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti demonstroi rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë rregulloren e sigurimit teknik;
- të përcaktojë rreziqet kryesore që mund të ndodhin;
- të përcaktojë shkaqet e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë masat dhe veprimet për mënjanimin e rreziqeve të mundshme;
- të përcaktojë pasojat nga moszbatimi i rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas rasteve konkrete;
- të demonstrojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga rryma elektrike, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të demonstrojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga përmytjet, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të demonstrojë masat dhe veprimet që ndërmerren në rast rreziku nga zjarri, sipas rregullores së sigurimit teknik;
- të përcaktojë, në përputhje me standardet e miratuara, masat dhe veprimet e dhënies së ndihmës së parë sipas

rasteve konkrete;

- të zbatojë masat për ruajtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarive profesionale të riparimit të pajisjeve elektroshtëpiake.
- të planifikojë masat e sigurisë në punë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli..

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së riparimeve elektroshtëpiake. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen riparime elektroshtëpiake.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të nxiten të marrin pjesë aktive si për diskutimin e çështjeve teorike, ashtu dhe për kryerjen e veprimtarive praktike. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në riparimin e pajisjeve elektroshtëpiake. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të riparuesit elektroshtëpiak, me funksionet, detyrat, veprimtaritë dhe rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit ku mbështetet puna e riparuesit elektroshtëpiak.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
- Mjedise reale të punës në repart riparimi elektroshtëpiak.
- Repart i riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake, i pajisur me kompletet e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
- Materiale të shkruara si rregullore, manuale, udhëzuesa etj.
- Materiale ilustruese (pankarta, transparente, makete, skema elektrike, skema kinematike të pajisjeve të thjeshta elektroshtëpiake etj.)

2. Moduli “Riparimi dhe zëvendësimi i elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake“

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RIPARIMI DHE ZËVENDËSIMI I ELEMENTEVE TË PAJISJEVE ELEKTROSHTËPIAKE	MK-11-052-18
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për përcaktimin e defekteve të thjeshta, eliminimin e tyre në motorë elektrikë, për zëvendësimin e elementeve si kondensatorin, relenë, rezistencën, çelësat, termostat e presostat etj, si dhe riparimin e pompave të ujit në pajisjet elektroshtëpiake.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përmbyshur modulin 1: “Hyrje në profesionin e riparuesit elektroshtëpiak“	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti riparon motorë elektrik.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e motorëve elektrik; – të dallojë llojet e dëmtimeve në motorë elektrikë; – të theksojë mënyrat e eliminimit të defekteve elektrike dhe mekanike në motorë; – të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e motorit elektrik; – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e motorëve elektrikë të pajisjes elektroshtëpiake; – të organizojë vendin e punës në repartin ku do të kryhet riparimi i motorëve elektrikë; – të interpretojë dokumentacionin teknik të motorëve elektrikë sipas pajisjes elektroshtëpiake; – të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e motorëve elektrikë; – të çmontojë motorin nga pajisja elektroshtëpiake; – të zbërthejë motorin në pjesët përbërëse; – të identifikojë defektin në motor; – të zëvendësojë kuzhinetën sipas kushteve teknike; – të zëvendësojë kapakun sipas kushteve teknike; – të zëvendësojë pulxhën sipas kushteve teknike; – prizhonjere sipas kushteve teknike; – të zëvendësojë rotorë sipas kushteve teknike; – të mbërthejë pjesët në motor; – të montojë motorin në pajisjen elektroshtëpiake; 	

- të kryejë provën përfundimtare pas riparimit të defektit në motor;
- të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjes e punës gjatë riparimit të motorit të pajisjes elektroshtëpiake;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të motorit të pajisjeve elektroshtëpiake;
- të pastrojë vendin e punës pas riparimit të motorit të pajisjes elektroshtëpiake;
- të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparimit të motorit të pajisjes elektroshtëpiake;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të motorit të pajisjes;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti zëvendëson elemente të pajisjeve elektroshtëpiake.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës’;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës;
- të organizojë vendin e punës;
- të interpretojë dokumentacionin teknik të elementeve të pajisjes elektroshtëpiake;
- të përcaktojë drejt radhën e punës për zëvendësimin e elementeve;
- të çmontojë elementet (kondenstor, rele, presostat, termostat etj.) nga pajisjet elektroshtëpiake sipas radhës së punës;
- të zëvendësojë elementet (kondenstor, rele, presostat, termostat, çelësa, rezistencë etj.) sipas kushteve teknike;
- të montojë elementet sipas radhës së punës ;
- të kryejë provën përfundimtare në agregat pas zëvendësimit të elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të pastrojë vendin e punës pas zëvendësimit të elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
- të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë zëvendësimit të elementeve të pajisjeve elektroshtëpiake;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti riparon pompa të ujit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e punës;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës;
- të organizojë vendin e punës;
- të analizojë dokumentacionin teknik të pajisjes sipas rastit;
- të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e pompës së ujit;
- të përcaktojë saktë defektet mekanike dhe elektrike të pompave të ujit;
- të çmontojë dhe montojë pompën e ujit nga pajisja;
- të zbërthejë pompën e ujit në pjesët përbërëse;
- të zëvendësojë pjesët e dëmtuara sipas kushteve teknike;
- të mbërthejë pjesët dhe të montojë pompën në agregat;
- të kryejë provën perfundimtare të funksionimit të pompës së ujit;
- të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjet e punës gjatë riparimit dhe zëvendësimit të çelësit dhe pompës së ujit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake;
- të pastrojë vendin e punës pas riparimit të pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake;
- të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të riparimit të pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake.
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së riparimeve elektroshtëpiake. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen riparime elektroshtëpiake.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për riparimin e defekteve në motor dhe zëvendësimin e tij, zëvendësimin e kondensatorit dhe relesë, rezistencës, çelësave, termostatit e presostatit, si dhe riparimin

dhe zëvendësimin e pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake.

- Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për riparimin e defekteve në motorë elektrikë, zëvendësimin e kondensatorit, relësë, rezistencës, çelësave, termostatit e presostatit, si dhe riparimin dhe zëvendësimin e pompës së ujit në pajisjet elektroshtëpiake, në përputhje me standardet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.
- Instruktori duhet të nxisë kursantët të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart riparimi elektroshtëpiak.
 - Repart i riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake, i pajisur me kompletet e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
 - Elementë të ndryshëm të pajisjeve elektroshtëpiake si : kondensatorë, rele, çelësa, termostat, presostat, rezistenca, pompa uji etj..
 - Komplete veglash dhe pajisjesh për këto punime
 - Materiale të nevojshme për kryerjen e riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake të thjeshta.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çeshtjeve që trajtohen (rregullore, manuale, standarde, pankarta etj.).
-

3. Moduli “Riparimi i pajisjeve elektrike ventiluese, ngrohëse dhe aspiruese”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RIPARIMI I PAJISJEVE ELEKTRIKE VENTILUESE, NGROHËSE E ASPIRUESE.	MK-11-053-18
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për të kryer riparimin e ventilatorit, aerotermit dhe thithësin e avujve.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përmbyshur modulën 1:”Hyrje në profesionin e riparuesit elektroshtëpiak” dhe modulën 2:” Riparimi i elementeve kryesorë të pajisjeve elektroshtëpiake”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti riparon ventilatorin. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të tregojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e ventilatorit; – të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e ventilatorit;. – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e ventilatorit; – të organizojë vendin e punës ku do të kryhet riparimi i ventilatorit; – të interpretojë dokumentacionin teknik të ventilatorit. – të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e ventilatorit; – të dallojë defektet në ventilator; – të kontrollojë ventilatorin dhe përcaktojë drejt defektet në të; – të zbërthejë dhe mbërthejë ventilatorin sipas radhës së duhur; – të riparojë defektet elektrike në ventilator; – të riparojë defektet mekanike në ventilator; – të bëjë provën përfundimtare të ventilatorit; – të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të ventilatorit; – të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjet e punës gjatë riparimit të ventilatorit; – të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të ventilatorit; – të pastrojë vendin e punës pas riparimit të ventilatorit; – të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e 	

-
- punës së riparimit të ventilatorit;
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të ventilatorit;
 - të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti riparon aerotermin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e aerotermit;
- të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e aerotermit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e aerotermit;
- të organizojë vendin e punës ku do të kryhet riparimi i aerotermit;
- të analizojë dokumentacionin teknik të aerotermit;
- të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e aerotermit;
- të dallojë llojet e defekteve në aeroterm;
- të kontrollojë aerotermin dhe përcaktojë drejt defektet;
- të zbërthejë dhe mbërthejë aerotermin, sipas radhës së duhur;
- të riparojë defektet elektrike në aeroterm;
- të riparojë defektet mekanike në aeroterm;
- të bëjë provën përfundimtare të aerotermit;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të aerotermit;
- të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjes e punës gjatë riparimit të aerotermit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të aerotermit;
- të pastrojë vendin e punës pas riparimit të ventilatorit të thjeshtë.
- të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparimit të ventilatorit të thjeshtë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të aerotermit;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti riparon thithësin e avujve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e thithësit të avujve;
- të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e thithësit të avujve;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e thithësit të avujve;
- të organizojë vendin e punës ku do të kryhet riparimi i thithësit të avujve;
- të interpretojë dokumentacionin teknik të thithësit të avujve;
- të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e thithësit të avujve;
- të dallojë llojet e defekteve në thithësin e avujve.
- të kontrollojë thithësin e avujve;
- të përcaktojë drejt defektet në thithësin e avujve;
- të çmontojë dhe montojë thithësit të avujve sipas radhës;
- të zbërthejë dhe mbërthejë pjesët e thithësit të avujve sipas radhës së duhur;
- të riparojë defektet elektrike në thithësin e avujve;
- të riparojë defektet mekanike në thithësin e avujve;
- të bëjë provën përfundimtare të funksionimit të thithësit të avujve;
- të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të thithësit të avujve;
- të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjet e punës gjatë riparimit të thithësit të avujve;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të thithësit të avujve;
- të pastrojë vendin e punës pas riparimit të thithësit të avujve;
- të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparimit të thithësit të avujve;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të thithësit të avujve;
- të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së riparimeve elektroshtëpiake. Rekomandohet që të bëhen vizita në mjedise e reparte ku bëhen riparime elektroshtëpiake.

- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.

-
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për riparimin e ventilatorit, aerotermit dhe thithësit të avujve.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprime konkrete për riparimin e ventilatorit, aerotermit dhe thithësit të avujve, në përputhje me standardet dhe rregullat e mbrojtjes në punë.
 - Instruktori duhet të nxisë kursantët të angazhohen në diskutime për rastet e ndryshme që paraqiten.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
 - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës në repart riparimi elektroshtëpiak.
 - Repart i riparimeve të pajisjeve elektroshtëpiake, i pajisur me kompletet e veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
 - Elementë të ndryshëm të pajisjeve elektroshtëpiake.
 - Komplete veglash dhe pajisjesh për këto punime
 - Materiale të nevojshme për kryerjen e riparimeve.
 - Ventilatorë të thjeshtë, aerotermë dhe thithës të avujve.
 - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen (rregullore, manuale, standarde, pankarta etj.).
-

4. Moduli “Riparimi i sobës së gatimit“

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	RIPARIMI I I SOBËS SË GATIMIT.	MK-11-054-18
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson kursantët për riparimin e pianurës dhe furrës së sobës elektrike, si dhe riparimin e sobës me gaz të gatimit.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë të aftë fizikisht dhe mendërisht dhe të jenë mbi 18 vjeç. Të kenë përmbyshur modulin1:”Hyrje në profesionin e riparuesit elektroshtëpiak” dhe moduli 2:” Riparimi i elementeve kryesorë të pajisjeve elektroshtëpiake”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti kryen punime riparimi në pianurën e sobës elektrike të gatimit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të tregojë përdorimin, ndërtimin dhe funksionimin e sobës elektrike për gatim. – të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e sobës elektrike për gatim. – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e pianurës së sobës elektrike të gatimit. – të organizojë vendin e punës për riparimin e pianurës së sobës elektrike të gatimit. – të interpretojë dokumentacionin teknik të sobës elektrike për gatim. – të përcaktojë drejt radhën e punës për riparimin e pianurës së sobës elektrike. – të kontrollojë pianurës e sobës dhe përcaktojë drejt defektet në të. – të çmontojë dhe montojë plitkat në pianurën e sobës elektrike, sipas radhës së duhur. – të zëvendësojë plitkat në pianurën e sobës elektrike. – të kontrollojë plitkat e zëvendësuar. – të çmontojë dhe montojë çelësat duke zbatuar kushtet teknike. – të zëvendësojë çelësat e dëmtuar me ato të rinj. – të kryejë kontrollin e çelsave. – të evidentojë dhe korrigjojë ndonjë gabim të mundshëm. – të përgatitë faturën për shërbimin e kryer. – të respektojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pianurës së sobës elektrike. – të përdorë siç duhet veglat dhe pajisjes e punës gjatë 	

-
- riparimit të pianurës së sobës elektrike të gatimit.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike të riparimit të pianurës së sobës elektrike të gatimit.
 - të pastrojë vendin e punës pas riparimit të pianurës së sobës elektrike të gatimit.
 - të pastrojë e mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparimit të pianurës së sobës elektrike të gatimit.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pianurës së sobës elektrike të gatimit.
 - të komunikojë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti riparon furrën elektrike të sobës elektrike.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë ndërtimin, funksionimin dhe përdorimin e furrës elektrike;
- të dallojë llojet e rezistencave të furrës elektrike;
- të veshë uniformën e punës përpara fillimit të punës për riparimin e furrës elektrike;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e punës për riparimin e furrës elektrike;
- të çmontojë dhe montojë furrën elektrike sipas radhës së duhur;
- të çmontojë rezistencat e dëmtuara të furrës elektrike;
- të zëvendësojë rezistencat sipas kushteve teknike;
- të kontrollojë çelsat me avometër;
- të zëvendësojë çelësat e dëmtuar;
- të kontrollojë termostatin;
